



Kuvendi i Komunës së Ferizajt:

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), të nenit 25, paragrafit 2.6 dhe 2.11, nenit 49, të Statutit të Komunës së Ferizajt (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 01.Nr. 50, më 28.06.2013) me datë 30.11.2022,

Miratoi:

RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

Ferizaj datë; 30.11.2022

Përmbajtja:	4
KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
Neni 1 - Qëllimi	4
Neni 2 - Fushëveprimi	4
Neni 3 - Përkufizimet	5
KAPITULLI II - KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE	5
Neni 4 - Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë	5
Neni 5 - Pagesa e taksave komunale	5
Neni 6 - Lirimet nga taksat komunale	6
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME	6
Neni 7 - Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile	6
Neni 8 - Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare	7
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË	7
Neni 9 - Taksat për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale	7
Neni 10 - Taksa për t'u pajisur me leje për hyrje në qytet për automjete transportuese dhe mallëra komerciale (vetëm për biznese)	7
Neni 11 - Taksat për regjistrimin e automjeteve	7
Neni 12 - Taksat për t'u pajisur me leje dhe licencë për TAXI	7
Neni 13 - Taksat për gjërmim/dëmtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbërta	8
Neni 14 - Tarifat nga Sektori i Energjetikës dhe Telekomunikimit	23
Neni __ - Tarifat dhe ngarkesat e ndryshme	24
Neni __ - Tarifat dhe ngarkesat për miniera dhe minerale	8
DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL	8
Neni 15 - Tarifat për shërbimet profesionale në zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerje në pyjet publike dhe private	8
Neni 16 - Tarifat e përgjithshme	8
Neni 17 - Taksat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore	8
Neni 18 - Shfrytëzimi i kullosave dhe lartësia e taksës	9
SEKTORI I INSPEKTORËVE KOMUNAL	9
Neni 19 - Inspektoriatet	10
DREJTORIA PËR PRONE, GJEODEZI DHE KADASTER	10
Neni 22 - Tarifat dhe ngarkesat e përgjithshme	15
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT	15
Neni 23 - Taksat për leje ndërtimi, rrënim, dhe rritje të densitetit	15
Neni 24 - Taksat për ndikim në infrastrukturë	15
Neni 25 - Lirimi nga taksat e ndërtimit, rrënim, ndikimit në infrastrukturë, dhe rritjes së densitetit	16

Neni 26 - Taksa komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësirat publike	16
Neni 27 - Taksa për rregullimin e tokës ndërtimore	17
DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZMIT	17
Neni 28 - Tarifat dhe ngarkesat e ndryshme	17
Neni 29 - Taksat për Shërbimet në Qendrën Komunale të Regjistrimit të Bizneseve	18
DREJTORIA E SHËNDETËSISË MIRËQENIES SOCIALE	18
Neni 30 - Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor	19
Neni 31 - Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësor	20
Neni 32 - Çmimorja për certifikatat shëndetësore	21
Neni 33 - Tarifat dhe ngarkesat	21
DREJTORIA E ARSIMIT	21
Neni 34 - Mësimi për të rritur (niveli i mesëm)	22
Neni 35 - Riprovimet e mësimi për të rritur pas kalimit të afatit ligjor të provimeve	22
Neni 36 - Provimet e klasës	22
Neni 37 - Kurset afatshkurta për ushtrimin e aktiviteteve zeytare	22
Neni 38- Regjistrimi në arsimin para universitar	22
Neni 39 - Shfrytëzimi i hapësirave dhe objekteve sportive të institucioneve arsimore	22
Neni 40 - Tarifat për pagesa në institucionet e edukimit të hershëm	24
KAPITULLI III - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	24
Neni 44 - Shtojcat	24
Neni 45 - Transparenca në taksat komunale	24
Neni 46 - Shfuqizimi	24
Neni 57 - Publikimi	25
SHTOJCA Nr.1 – Tarifat komunale të përcaktuara sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje	29
SHTOJCA Nr.2 – Tarifat qendrore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës	38
SHTOJCA Nr.3 – Shërbimet tjera administrative	

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Ferizajt (këtu e tutje "Komuna"), lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kategorive të liruar nga kjo taksë.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Përkufizimet

3.1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

3.1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

3.1.1.1. Lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;

3.1.1.2. Shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;

3.1.1.3. Pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;

3.1.1.4. Ndërtimit, rrënimt të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe

3.1.1.5. Shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.

3.1.2. **Taksa qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mbliidhen nga Komuna;

3.1.3. **Vit fiskal** – nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) janar të të njëjtët vit;

3.1.4. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;

3.1.5. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;

3.1.6. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

3.1.7. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër.

KAPITULLI II

KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale

- 4.1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.
- 4.2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e mosdiskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 4.3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
- 4.4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

- 5.1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
- 5.2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagesë të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës.
- 5.3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
- 5.4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
- 5.5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit.

Neni 6

Lirimet nga taksat komunale

- 6.1. Të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
- 6.2. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
- 6.3. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
- 6.4. Nëse ndonjë procedura ku kërkohet pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruara nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruara nga pagesa.

I. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME

Neni 7

Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile

7.1.	Certifikatë Lindje	1 €
7.2.	Ekstrakt Lindje	1 €
7.3.	Certifikatë e Martesës	1 €
7.4.	Certifikatë e Statusit Martesor	1 €
7.5.	Certifikatë Shtetësie	1 €
7.6.	Certifikatë Vendbanimi	1 €
7.7.	Certifikatë për lajmërim /ç'lajmërim të vendbanimit	1 €
7.8.	Vërtetim nga Arkiva	1 €
7.9.	Certifikatë e Bashkësisë Familjare	1 €
7.10.	Certifikatë e Vdekjes	2 €
7.11.	Akti i Vdekjes	10 €
7.12.	Kurorëzimet gjatë orarit të punës	
7.13.	Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve në institucionet shëndetësore që kanë kaluar afatin ligjor 30/tridhjetë ditë)	20-50 €
7.14.	Regjistrimet e mëvonshme e të të lindurve jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës që kanë kaluar moshën 12 vjeçare	20-50 €
7.15.	Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve jashtë territorit të R. së Kosovës që nuk janë regjistruar në Shtetin e Lindjes	20 €
7.16.	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjes për persona të cilët nuk mund të ofrojnë asnjë dëshmi	20-50 €
7.17.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes në institucionet shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës	50-100 €
7.18.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës	50-100 €
7.19.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë territorit të R. së Kosovës kur nuk është regjistruar vdekja në shtetin e vdekjes	50-100€
7.20.	Regjistrimet e mëvonshme të vdekjeve kur nuk është regjistruar lindja dhe vdekja	50-100€
7.21.	Korrigjimi i emrit personal	2 €
7.22.	Ndërrimi i emrit personal	10 €
7.23.	Ndërrimi i emrit personal (rikthimi i mbiemrit të vajzërisë/djalërisë pas shkurorëzimit)	5 €
7.24.	Korrigjimi dhe plotësimi në dokumentet e arkivuara	2 €

Neni 8

Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

- 8.1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare janë të liruar kategoritë në vijim:
- 8.1.1. Veteranët e luftës
 - 8.1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e ngushtë të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së

- 8.1.3. Personat me aftësi të kufizuara
- 8.1.4. Përfituesit e skemave sociale
- 8.1.5. Pensionistët
- 8.1.6. Organizatat jo-qeveritare
- 8.1.7. Ish të burgosurit politik

II. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Neni 9

Leje për keyerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave

9.1	Licensë/Leje auto-taksi (taksi individual 5 vite)	50 euro
9.2	Licensë/Leje për operator taksi (5 vite)	250 euro
9.3	Licensë/Leje për transport urban dhe urban-periferik (5 vite)	150 euro
9.4	Licensë/Leje për kryerjen e transportit rrugor të mallrave deri 12 ton. (5 vite)	50 euro

Neni 10

Rendet e udhëtimit

10.1. Vërtetimi, vazhdimi i rendëve të udhëtimit në transportin publik të udhëtarëve urban dhe urbano periferik, pages për tri vite bëhet 0.5 euro për km për çdo nisje që aplikon dhe 5 euro paraqitja për aplikim.

Neni 11

Leje për mbyllje të trotuarit shiritit rrugor apo rrugës me kohë të caktuar

11.1	Pagesë me kohë të caktuar	10 euro/orë
------	---------------------------	-------------

Neni 12

Leje për ndalje të përkohëshme në rrugë për ngarkim shkarkim të mallrave të ndryshme

12.1	Pagesë mujore	10 euro
------	---------------	---------

Neni 13

Leje e përkohëshme për hyrje në shesh/qytet me mjete motorike

13.1	Pagesë ditore	5 euro
13.2	Pagesë vjetore	150 euro

Neni 14

Taksat për marrjen e pëlqimit/certifikates për keyerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave

14.1.	Për automjetet 5 (4+1) ulëse	10 euro
14.2.	Për automjetet transportuese/minibus dhe autobus	25 euro
14.3.	Për automjetet transportuese të mallrave deri 12 ton	15 euro

Neni 15

Vazhdimi i Licencës/Lejes për keyerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave

15.1. Taksat për vazhdimin e Licencës/Lejes për keyerjen e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave aplikohen sipas të njëjtave tarfiave të nenit 9.

Neni 16

Taksat për regjistrimin e automjeteve

16.1. Për automjete deri në 3.5t	10 €
16.2. Për automjete mbi 3.5t	20 €

Neni 17

Taksat për gjërmim/dëmtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbërta

17.1. Taksa për gjërmim/dëmtim të rrugëve me asfalt	20 €/m'
17.2. Taksa për gjërmim/dëmtim të rrugëve me kube dhe kthimi në gjendje të mëparshme	10 €/m'
17.3. Taksa për gjërmim/dëmtim të sipërfaqeve të gjelbërta, me zhavor, dhe sipërfaqe të tjera të papërpunuara dhe kthimi në gjendje të mëparshme	0 €/m'
17.4. Nga taksa komunale për gjërmim të rrugës, lirohen të gjithë operatorët të cilët me kërkesë të komunës do të investojnë në përmirësimin e infrastrukturës komunale.	

Neni 18

Tarifat e përgjithshme nga Sektori i Energjetikës dhe Telekomunikimit

18.1 Shfrytëzimi i hapësirës publike me orman dhe pajisje tjera për energjetikë dhe telekomunikim	10 € / m ² (tarifë vjetore)
---	---

Neni 19

Tarifat dhe ngarkesat e ndryshme

19.1 Të gjitha veprimet në kuadër të masave për mbrojtje nga zjarri dhe i tërë dokumentacioni në këtë lëmi lëshohen nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME) ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.

Neni 20

Tarifat për miniera dhe minerale

20.1 Do të zbatohet Ligji Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për miniera dhe minerale, Ligji për miniera dhe minerale Nr.03/L-163 si dhe udhëzimet administrative të zbatueshme për këtë lëmi.

III. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 21

Tarifat për shërbimet profesionale në zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerje në pyjet publike dhe private

21.1. Për zgjedhjen, damkimin, dhe lëshimin e lejeve për prerjen e trungjeve të klasifikuar si asortiment teknik (industrial) dhe për trungjet e klasifikuar si dru për djegie, do të zbatohen tarifat si vijonë:

- 21.1.1. për zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru teknik **3 €/m³**
- 21.1.2. për zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru zjarri, me vëllim më të vogël se 7 m³ (me qëllim të përdorimit për nevoja shtëpiake) **1.50 €/m³**
- 21.1.3. për zgjedhjen & damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru zjarr, me vëllim më të madh se 7 m³ **2 €/m³**

Neni 22

Tarifat e përgjithshme

- 22.1. Vlerësimi i dëmit të pyjeve, vreshtave, pemishteve dhe pasurive tjera bujqësore **0 €**
- 22.2. Certifikata për prodhues bujqësorë nga lëmia e bujqësisë dhe hidroekonomisë **0 €**

Neni 23

Taksat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore

23.1. Shuma e pagesës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore varet nga klasifikimi i tokës përkatëse, si në vijim:

- 23.1.1. Ndërrimi i destinimit të tokës së klasës 1-4 **1 € / m²**
- 23.1.2. Ndërrimi i destinimit të tokës së klasës 5-6 **0.75 € / m²**
- 23.1.3. Ndërrimi i destinimit të tokës së klasës 7-8 **0.50 € / m²**

23.2. Nëse ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore është bërë në pajtim me planin hapësinor, do të zbatohet kompensimi në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

23.3. Për ndërrim të përkohshëm të destinimit duhet të paguhet kompensimi 20% për metër katror sipas klasifikimit së përcaktuar në tarifat bazë në paragrafin 1 të këtij neni.

23.4. Lartësia e kompensimit është përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Neni 24

Shfrytëzimi i kullotave dhe Lartësia e Taksës

24.1 Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Shfrytëzimin e Kullosave.

24.2 Komuna jep në shfrytëzim tokën komunale në pronësi të komunës për destinim bujqësorë në shumën prej 50.00 € për hektar, e cila shumë është taksë vjetore.

24.3 Kullotat publike ipen në shfrytëzim me kontratë të lidhur në mes organit përgjegjës për menaxhimin e kullotave dhe personave të interesuar për marrjen e kullotave në shfrytëzim.

24.4 Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullotave caktohet në bazë të llojit dhe kategorisë së bagëtisë. Taksat për shfrytëzimin e kullotave publike është 1.20 Eur për njësi blegtorale (NB). Tabela e mëposhtme paraqet njësitë blegtorale sipas llojit të bagëtisë dhe lartësinë e taksës për kokë të bagëtisë:

Lloji i bagëtisë	NB / kokë	EUR / kokë
1. Gjedhet mbi një vit	1	1.20
2. Viçat	0.45	0.54
3. Delet	0.18	0.22
4. Qengjat	0.1	0,12
5. Kuajtë dhe Gomarët	1	1.20
6. Dosat	0.5	0.60
7. Derrat	0.3	0.36
8. Rosat	0.014	0.02

IV. SEKTORI I INSPEKTORËVE KOMUNAL

Neni 25

25.1. Kërkesë për kontroll inspektues në qytet dhe jashtë qytetit nga persona fizikë dhe juridik	0 €
25.2. Kërkesë për verifikimin e fazave ndërtimore me protokoll se a janë duke u kryer punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore në objektet për banim individual	0 €
25.3. Kërkesë për verifikimin e fazave ndërtimore me protokoll se a janë duke u kryer punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore në objektet për banime kolektive, me afarizëm, etj.	0 €
25.4. Kërkesë për verifikimin e fazave ndërtimore me protokoll se a janë duke u kryer punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore në objektet publike dhe private, ku investitor është Komuna e Ferizajt	0 €
25.5. Pëlqime të ndryshme nga sektori i ndërtimitarisë	20 €
25.6. Kërkesë për asgjësim mallrash	
25.7. Pëlqim rreth plotësimit të kushteve minimale teknike të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare	15 €

V. DREJTORIA PËR PRONË, GJEODEZI DHE KADASTR

Neni 26

Tarifat dhe ngarkesat e përgjithshme

Tarifat e mëposhtme janë përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 09/2020 për tarifën e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 12/2019 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, si dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 11/2019 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës, Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAE) Nr. 09/2020 për Tarifën e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

26.1. Informatat nga sistemi i informacioneve kadastrale për tokën në Kosovë

26.1.1.	Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona	3 €
26.1.2.	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	4 €
26.1.3.	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	20 €
26.1.4.	Kopja e planit	4 €
26.1.5.	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi)	4 €
26.1.6.	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	5 €
26.1.7.	Historiati për një njësi kadastrale	20 €
26.1.8.	Vërtetime të ndryshme (për raste sociale pa pagesë)	5 €

26.2. Baza Gjeodezike

26.2.1.	Pikat trigonometrike (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	5 €
26.2.2.	Pikat lidhëse (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	4 €
26.2.3.	Pikat poligonale (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	3 €
26.2.4.	Pikë e nivelimit (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	5 €
26.2.5.	Pikat në linjë (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	2 €
26.2.6.	Pikat e detajit (Koordinatat Y, X, H me përshkrim)	1 €

26.3. Të dhënat në formë digjitale

26.3.1.	Parcela në format digjital deri në 1 ha, për një njësi	10 €
26.3.2.	Parcela në format digjital mbi 1 ha deri në 2 ha, për një njësi	20 €
26.3.3.	Parcela në format digjital mbi 2 ha deri në 5 ha, për një njësi	40 €
26.3.4.	Parcela në format digjital mbi 5 ha	60 €
26.3.5.	Ndërtesa në format digjital	5 €
26.3.6.	CD – kompakt disku (për parcela si dhe ndërtesa)	0.50 €

26.4. Ndërrimi i kulturave të parcelave

26.4.1.	Ndërrimi i kulturës së një parcele pa matje gjeodezike	10 €
26.4.2.	Ndërrimi i kulturës së një parcele me matje bëhet sipas tarifave në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.	

26.5. Ndarja e parcelave

26.5.1.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe deri në 0.50 ha për një njësi	80 €
26.5.2.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri në 1 ha për një njësi	90 €
26.5.3.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe mbi 1 ha deri në 2.5 ha për një njësi	120 €

26.5.4.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri në 5 ha për një njësi	140 €
26.5.5.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe mbi 5 ha deri në 10 ha për një njësi	170 €
26.5.6.	Ndarja e parcelës me sipërfaqe mbi 10 ha për një njësi	300 €
26.5.7.	Ndarja e parcelës në zona urbane sipas planit urbanistik për një njësi	150 €
26.6. Bashkimi i parcelave		
26.6.1.	Bashkimi i dy parcelave	80 €
26.6.2.	Për çdo parcelë tjetër në kufi	35 €
26.6.3.	Bashkimi i dy parcelave në zona urbane sipas planit urbanistik	150 €
26.6.4.	Për çdo parcelë tjetër në kufi	70 €
22.7. Përcaktimi i kufijve të parcelave		
26.7.1.	Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha	130 €
26.7.2.	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri në 1 ha	180 €
26.7.3.	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 1 ha deri në 2.5 ha	220 €
26.7.4.	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri në 5 ha	330 €
26.7.5.	Për çdo hektar tjetër	100 €
26.7.6.	Për një parcelë urbane sipas planit urbanistik	300 €
26.8. Ri-rregullimi i kufijve të parcelave		
26.8.1.	Për një parcelë me sipërfaqe deri në 50 ha	80 €
26.8.2.	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 50 ha deri në 1 ha	100 €
26.8.3.	Për çdo parcelë tjetër mbi 1 ha	100 €
26.9. Punët e veçanta gjeodezike sipas kërkesave të palëve		
26.9.1.	Identifikimi i njësive kadastrale në zyre	10 €
26.9.2.	Identifikimi i njësive kadastrale në terren	30 €
26.9.3.	Konsulta profesionale (për orë)	10 €
26.9.4.	Bartja – piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual	1 €/m ²
26.9.5.	Bartja – piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist	1.50 €/m ²
26.10. Matja e ndërtesave		
26.10.1.	Matja e bazamentit të ndërtesave individuale (shtëpi banimi) deri në 100 m ²	100 €
26.10.2.	Matja e bazamentit të ndërtesave individuale (shtëpi banimi) mbi 100 m ²	1 €/m ²
26.10.3.	Matja e bazamentit të ndërtesave të banimit kolektiv	1.20 €/m ²
26.10.4.	Matja e bazamentit të ndërtesave banesore / afariste	1.50 €/m ²
26.10.5.	Matja e bazamentit të ndërtesave qeveritare dhe publike	1 € m ²
26.10.6.	Matja e bazamentit të ndërtesave sportive	1 €/m ²
26.10.7.	Matja e bazamentit të ndërtesave kulturore dhe fetare	0.50 € m ²
26.11. Matja e pjesëve të ndërtesave		
26.11.1.	Matja dhe përpilimi i skicave të njësive banesore si dhe hapësirave të përbashkëta deri në 75 m ² , për njësi	80 €

26.11.2.	Matja dhe përpilimi i skicave të njësive banesore si dhe hapësirave të përbashkëta mbi 75 m ²	1.20 €/m ²
26.11.3.	Ndarja e hapësirave të njësive afariste si dhe hapësirave të përbashkëta deri në 75 m ² , për njësi	110 €
26.11.4.	Ndarje e hapësirave të njësive afariste si dhe hapësirave të përbashkëta deri mbi 75 m ²	1.50 €/m ²
26.12. Regjistrimi i pronësisë në bazë të vlerës së transaksioneve		
26.12.1.	Për vlerën e transaksionit deri në 10,000 €	30 €
26.12.2.	Për vlerën e transaksionit prej 10,001 € deri në 50,000 €	50 €
26.12.3.	Për vlerën e transaksionit prej 50,001 € deri në 100,000 €	70 €
26.12.4.	Për vlerën e transaksionit prej 100,001 € deri në 200,000 €	90 €
26.12.5.	Për vlerën e transaksionit prej 200,001 € deri në 500,000 €	120 €
26.12.6.	Për vlerën e transaksionit prej 500,001 € deri në 1,000,000 €	240 €
26.12.7.	Për vlerën e transaksionit mbi 1,000,000 €	500 €
26.12.8.	Për vlerën e transaksionit që është vërtetuar para vitit 1999	50 €
26.13. Regjistrimi i pronësisë në bazë të dokumentit mbi dhuratën		
26.13.1.	Regjistrimi i pronësisë sipas kontratës së dhurimit për anëtarin e familjes	30 €
26.13.2.	Regjistrimi i pronësisë sipas kontratës së dhurimit për personin që nuk është anëtar i familjes dhe kur nuk është caktuar vlera e pronës	80 €
26.13.3.	Për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes, zbatohet tarifa sipas pikës 12 të këtij neni.	
26.14. Regjistrimi i pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme		
26.14.1.	Regjistrimi i pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që është anëtar i familjes (për çdo pronar)	30 €
26.14.2.	Regjistrimi i pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që nuk është anëtar i familjes dhe kur nuk është caktuar vlera e pronës	80 €
26.14.3.	Për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe mbajtësi nuk është anëtar i familjes, zbatohet tarifa sipas pikës 12 të këtij neni.	
26.15. Regjistrimi i pronësisë në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore		
26.15.1.	Regjistrimi i të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor (për çdo pronar)	30 €
26.16. Regjistrimi i bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët		
26.16.1.	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët	30 €
26.16.2.	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortët	30 €

26.16.3.	Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale si pjesë e ndërtesës	22 €
26.16.4.	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi	0 €
26.16.5.	Regjistrimi i hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta	0 €
26.17. Regjistrimi i ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët		
26.17.1.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronar individual	30 €
26.18. Regjistrimi i pronësisë apo posedimit në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare		
26.18.1.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë (për çdo trashëgimtar)	10 €
26.18.2.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë e cila rrjedh nga testamenti (për çdo trashëgimtar)	20 €
26.18.3.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar	20 €
26.19. Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme		
26.19.1.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar	40 €
26.20. Regjistrimi, modifikimi, dhe fshirja e hipotekës		
26.20.1.	Kërkesë (kredia) në vlerë deri në 30,000 €	20 €
26.20.2.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 30,001 € deri në 50,000 €	30 €
26.20.3.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 50,001 € deri në 100,000 €	60 €
26.20.4.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 100,001 € deri në 200,000 €	90 €
26.20.5.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 200,001 € deri në 500,000 €	120 €
26.20.6.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 500,001 € deri në 1,000,000 €	240 €
26.20.7.	Kërkesë (kredia) në vlerë mbi 1,000,000 €	400 €
26.20.8.	Modifikimi i hipotekës së regjistruar	10 €
26.20.9.	Fshirja e hipotekës së regjistruar	0 €
26.21. Regjistrimi, modifikimi, dhe fshirja e servitutit		
26.21.1.	Regjistrimi i së drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person	30 €
26.21.2.	Modifikimi i servitutit	10 €
26.21.3.	Fshirja e servitutit nga regjistri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme	20 €
26.22. Regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit – qirambajtje		
26.22.1.	Regjistrimin i së drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite	10 €
26.22.2.	Regjistrimin i së drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej 10 - 40 vite	30 €
26.22.3.	Regjistrimin i së drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej 40- 99 vite	50 €
26.22.4.	Regjistrimi i qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në 10 vite për çdo njësi kadastrale	10 €

26.22.5. Regjistrimi i qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi 10 vite për çdo njësi kadastrale 20 €

26.23. Regjistrimi, modifikimi, dhe fshirja e barrave dhe ngarkesave tjera

26.23.1. Regjistrimi i masës së sigurisë (masa e përkohshme) ku procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private 50 €

26.23.2. Regjistrimi apo modifikimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) kur procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare 0 €

26.23.3. Regjistrimi i vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme 40 €

26.23.4. Regjistrimi i ndalesës nga përmbaruesi privat apo gjykata në procedurë përmbartimore për secilën njësi kadastrale 30 €

26.23.5. Regjistrimi i vërejtjes të mbajtësit të pronës së paluajtshme në momentin e lidhjes së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme 20 €

26.23.6. Modifikimi i barrës apo ndonjë ngarkese tjetër 10 €

26.23.7. Fshirja e barrës apo ndonjë ngarkese tjetër 0 €

26.23.8. Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme të cilat nuk janë të përfshira me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2020 50 €

26.24. Korrigjimi i të dhënave kadastrale

26.24.1. Korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga pala 30 €

26.24.2. Korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të zyrtarëve të ZKK apo AKK 0 €

26.24.3. Korrigjimi i numrit identifikues "KCID" në numrin personal të pronarëve 0 €

26.25. Shërbimet administrative

26.25.1. Regjistrimi, ndërrimi (bartja) apo fshirja e poseduesit të ri apo të drejtave mbi paluajtshmëritë 20 €

VI. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT

Neni 27

Taksat për leje ndërtimi, rrënim, dhe rritje të densitetit

27.1 Taksat/tarifat komunale sipas kësaj rregulloreje janë përcaktuar, sipas shërbimeve që do të marrin të gjithë personat fizik dhe juridik, që operojnë në territorin e komunës së Ferizajt.

27.2. Taksat/tarifat nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, do të aplikohen sipas shërbimeve të kryera, lejeve të lëshuara etj. sipas tabelave të poshtëshënuara.

27.3. Taksat/tarifat për pajisje me leje ndërtimore (ndërtim të lartë dhe individual), llogaritet sipas projektit zbatues që ofrojnë personat fizik dhe juridik dhe llogaritet me sipërfaqe bruto të gabaritit të jashtëm të objektit.

27.4. Lartësia e taksës sipas kësaj dispozite, llogaritet për të gjitha objektet banesore, objektet ekonomike të ndërtuara me material të fortë dhe sistem montazh, ku kërkohet leja ndërtimore.

27.5 Caktimi i lartësisë së taksë ndërtimore bëhet sipas tabelës nr. 3.

27.6 Tarifa e lejes ndërtimore aplikohet për ndërtimet të hapësirave të banimit, ndërtimi i ri, rindërtim, aneks ndërtim dhe rikonstruktimin e objekteve.

27.8 Tarifa për lejen ndërtimore për lokale afariste të ndërtimit të fortë dhe ndërtimit montazhe, për hapësira bruto llogaritet sipas tabelës nr.4.

Tabela Nr.3

Nr.	Ndërtimi i objekteve për banim dhe afarizëm	Shuma/€
1	Taksa administrative ndërtimore për kategorinë e I-rë në sip. bruto m ²	1.90 €
2	Taksa administrative ndërtimore për kategorinë e II-të në sip. bruto m ²	4.70 €
3	Taksa e densitetit të infrastrukturës për të gjitha kategoritë në sip. bruto në m ²	4.00 €
4	Taksa për Rrënim në sip. bruto në m ²	0.70 €

Tabela Nr.4

Nr.	Hapësirat afariste	Shuma/€
1	Taksa ndërtimore në sipërfaqen bruto në m ² (ekonomike, ndërtimet e forta, ndërtimet montazhe, ndërtimet e përkohshme)	6.80 €
2	Taksa ndërtimore në sipërfaqen bruto në m ² (fabrikat për prodhim)	0.30 €
2	Taksa për Shtalla në sip. bruto në m ²	0.30 €
3	Taksa për Silose në sip. bruto në m ³	0.30 €

Neni 28

Taksat për ndikim në infrastrukturë

28.1. Çdo person që ndërton një ndërtesë të re apo rehabiliton substancialisht një ndërtesë ekzistuese, me anë të së cilës ndikohet drejtpërdrejtë infrastruktura komunale dhe ky veprim kërkon krijimin, përmirësimin, riparimin, apo zgjerimin e kësaj infrastrukture, paguan taksë komunale për ndikim në infrastrukturë.

28.2. Taksa komunale për ndikim të infrastrukturë përcaktohet bazuar në listën e shpenzimeve për llojet e ndryshme të infrastrukturës, si në vijim:

28.2.1. Gropime në rrugë

28.2.2. Vendosja e gypave të ujës-jellësit, kanalizimit

28.2.3. Shtirirja e rrjetit nëntokësor nga KEDS

- 28.2.4. Shtrirja e rrjetit nëntokësor nga Telekom, Vala, Ipko
 - 28.2.5. Shtrirja e rrjetit kabllovik nga operatorë të ndryshëm
 - 28.2.6. Rregullimi i parqeve, shesheve të qytetit
 - 28.2.7. Asfaltimi i rrugëve
 - 28.2.8. Shtrimi i trotuareve, rrugëve me kubëza
 - 28.2.9. Rregullimi-revitalizimi i urave të qytetit
 - 28.2.10 Dhënia e Pelqimeve për vendosjen e paneleve solare
- 28.3. Llogaritja e taksës komunale për ndikim në infrastrukturë bëhet në sipërfaqe bruto në metër në katror (m²) të objektit, sipas dokumentacionit teknik – projektit kryesor, për të cilin është dhënë miratimi dhe në bazë të të cilit lejohet ndërtimi.
- 28.4. Pas vlerësimeve të bëra, Komuna lidh marrëveshje me shkrim me aplikuesin për lejes ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 29

Lirimi nga taksat e ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë, dhe rritjes së densitetit

- 29.1. Nga pagesa e taksës të ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit janë të lira kategoritë ndërtimore si në vijim:
- 29.1.1. Ndërtimet të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
 - 29.1.2. Ndërtimet të cilat financohen përmes donacioneve apo garantëve për interes të publikut në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike;
 - 29.1.3. Ndërtimet e objekteve për banim individual (shtëpi deri 100 m²) të cilat ndërtohen ekskluzivisht me donacione, për përfituesit e skemës së ndihmës sociale;
 - 29.1.4. Ri-ndërtimet e ndërtimeve të shkaktuara si rezultat i luftës, trazirave shoqërore ose forcës madhore, dhe;
 - 29.1.5. Ndërtimet e objekteve arsimore, kulturore, fetare, sportive, shëndetësore, si dhe qendrat rekreative, që ndërtohen me mjete buxhetore, me investime të komunitetit apo me donacione, si dhe objektet tjera që ndërtohen nga donatorë vendor ose të huaj dhe që janë të interesit të përgjithshëm.

Neni 30

Taksat komunale për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësirat publike

- 30.1. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:
- 30.1.1. Vendosja e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese (lëvizëse) për zhvillim të veprimtarisë tregtare, përfshirë vitrinat; tavolinat shitëse-lëvizëse; stendat e hapura lëvizëse stinore; pajisjet për shitje të pofkave, misrit, gështenjave, pomfritit, petullave, palagaqeve dhe artikujve të ngjashëm; aparatet dhe frigoriferat statik për akullore; auto-frigoriferat; automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimeve të shpejta; dhe veturat për ekspozim me qëllim të promovimit të lojërave shpërblyese, etj.:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për metër katror për objekte deri 10m ²	4 €	2 €	1 €
Pagesa mujore për metër katror për objekte mbi 10 m ²	4 €	1.5 €	1 €

26.1.2. Vendosija e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për metër katror (m^2)	3 €	2 €	2 €

30.1.3. Vendosija e gjeneratorëve statik në hapësira publike, për gjenerator mbi $2m^2$:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa vjetore për metër katror (m^2)	50 €	20 €	10 €

30.1.4. Vendosija e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese rekreative si kamp-shtëpiza, lojëra për fëmijë, etj.:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për hapësirat mbi $10 m^2$ për metër katror (m^2)	10 €	8 €	5 €

30.1.5. Vendosija e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera montuese (kioskat, barakat, garazhet etj.)

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për baraka dhe garazhe, për metër katror (m^2)	4 €	3 €	1 €
Pagesa mujore për kioska, për metër katror (m^2)	7 €	6 €	5 €

30.1.6. Vendosija e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera, baner, city light, bilbordet, ekranet reklamuese, si dhe forma tjera te reklamimit etj.:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për hapësirat për metër katror (m^2)	3 €	2.5 €	2 €

30.1.7. Vendosija e objekteve të përkohshme apo objekteve tjera në hapsirat private, baner, city light, bilbordet, ekranet reklamuese, si dhe forma tjera te reklamimit etj.:

	Zona I	Zona II	Zona III
Pagesa mujore për hapësirat për metër katror (m^2)	2.5 €	2 €	1.5 €

Neni 31

Taksa për rregullimin e tokës ndërtimore

Zbatohet Vendimi për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në Territorin e Qytetit të Ferizajt paraprakisht i miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 32

Taksat për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale

- 32.1. Për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguajë:
28.1.1 në vlerën investive të projektit deri në 25,000 Euro, paguhet tarifa në vlerë prej 50 Euro;
28.1.2 në vlerën investive të projektit mbi 25,000 Euro, paguhet 0.2 % e vlerës investive të projektit.
- 32.2. Kjo tarifë është përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.01/2017 për pajisje me Leje Mjedisore Komunale.

VII. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZMIT

Neni 33

Taksat për Shërbimet në Qendrën Komunale të Regjistrimit të Bizneseve

- 33.1. Taksat që aplikohen nga ARBK-QKRB për Shoqëritë Tregtare bazohen vetëm në llojin e shërbimit që ofrohet nga ARBK dhe nuk mund të bazohen në asnjë mënyrë në vlerën e qarkullimit apo në kapitalin e Shoqërisë Tregtare.
- 33.2. Llojet e shoqërive tregtare të cilat janë të themeluara dhe ato që mund të themelohen në Republikën e Kosovës, sipas ligjeve në fuqi i nënshtrohen pagesës së taksave si në vijim:
- 33.2.1. Taksat për Shoqëri Aksionare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Ortakëri të Kufizuar, Degë të Shoqërisë së Huaj Tregtare, dhe Kooperativë Bujqësore:
- | | |
|--|--------|
| 2.1.1. Harmonizimi ose rifreskimi komplet i statutit ose memorandumit | 5 € |
| 2.1.2. Regjistrimi fillestar i biznesit | 0 € |
| 2.1.3. Kërkesa për shuarje të biznesit e shuarje njësisë | 0 € |
| 2.1.4. Regjistrimi dhe çdo ndryshim i njësisë | 5 € |
| 2.1.5. Ndryshim dhe bartje emrit zyrtar dhe emrit tregtar të biznesit | 5 € |
| 2.1.6. Ndryshime të personave të autorizuar (Përfaqësuesit e Autorizuar, Drejtorët dhe Bordi i Drejtorëve) | 5 € |
| 2.1.7. Ndryshimi i adresës dhe emrit të biznesit. Adresës së banimit të pronarët apo përfaqësuesve të Autorizuar dhe Numrit të telefonit të biznesit dhe emailit | 5 € |
| 2.1.8. Ndërrim i pronarëve dhe ndryshimi i kapitalit dhe vlerës së aksioneve | 5 € |
| 2.1.9. Ndryshimi i veprimtarive të biznesit | 5 € |
| 2.1.20. Ndërrimi i tipit të biznesit; bashkimi ose ndarja e Shoqërisë Tregtare | 0 € |
| 2.1.21. Ndërrimi i numrit të punëtorëve. | 2 € |
| 2.1.22. Marrja e Certifikata duplikat apo me datë të re | 0 € |
| 2.1.23. Kërkes për marrjen e Vërtetimi duplikat për shuarje të biznesit | 1 € |
| 2.1.24. Vërtetim lidhur me biznesin, pronar apo drejtor dhe Vërtetim që nuk ka biznes | 0.50 € |
| 2.1.25. Vërtetimi (vulosja) e çdo kopjes autentike për faqe | |
| 2.1.26. Informatat, Historia e biznesit apo marrja e fotokopjes së dokumenteve të biznesit për faqe 0.20 € | 0.50 € |
| 2.1.27. Lëshimi i Informatave në formë elektronike për 10KB (kilobajt) për faqe | 0.50 € |
- 33.2.2. Taksat për Biznes Individual dhe Ortakëri të Përgjithshme:
- | | |
|---|-----|
| 2.2.1. Regjistrimi fillestar i biznesit | 0 € |
|---|-----|

2.2.2. Kërkesa për shuarje të biznesit	0 €
2.2.3. Ndryshimi i adresës dhe emrit Tregtar, Adresës së banimit të pronari apo Përfaqësuesit të Autorizuar dhe Numrit të telefonit të biznesit dhe emailit	2.50 €
2.2.4. Ndryshimet të personat e autorizuar (Përfaqësuesi i Autorizuar apo drejtorit)	2.50 €
2.2.5. Regjistrimi dhe çdo ndryshim të njësisë e Veprimtaris	2.50 €
2.2.6. Ndërrimi i formës së biznesit nga B.I. në O.P. apo e kundërta	0 €
2.2.7. Ndërrimi i numrit të punëtorëve.	2 €
2.2.8. Marrja e Çertifikata duplikat apo me datë të re	0 €
2.2.9. Kërkesë për marrjen e Vërtetimi duplikat për shuarje	1 €
2.2.10. Vërtetim lidhur me biznesin, pronar apo drejtor dhe vërtetim që nuk ka biznes	0.50 €
2.2.11. Vërtetim (vulosja) e çdo kopjes autentike për faqe	
2.2.12. Informatat, historia e biznesit apo marrja e fotokopje së dokumentit të biznesit për faqe	0.20 €
2.2.13. Lëshimi i Informatat në formë elektronike për 10KB (kilobajt) për faqe	0.50 €

33.2.3 Këto tarifa janë përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ (MINT) Nr. 12/2022 për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga ARBK.

33.3. Lartësia e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave në pronësi të komunës, vlera minimale është caktuar 1.10 € për 1m².

33.4 Objektet, banesat dhe lokalet afariste në pronësi të komunës i jepen me qira të gjithë personave fizik dhe juridik, banesat e komunës mund të ipen me qira edhe për raste sociale.

33.4.1 Lartësia e qirasë së çmimit fillestar është në shumën prej 5.00 € për 1 m², zona I Qender ndërsa për zonat e tjera çmimi minimal trajtohet sipas çmimorese se zonave të përcaktuara nga drejtorja e Urbanizmit kurse çmimin përfundimtar e përcakton ofertuesi më i shtrenjtë në bazë të një ankandi publik të cilin e organizon administrata komunale. Çmimi i qirasë është qiraja mujore.

33.4.2 Marrja në shfrytëzim e lokaleve afaristeve dhe banesave në pronësi të komunës bëhet me marrëveshje-kontratë me shkrim e cila bënë specifikimin e kushteve për marrjen në shfrytëzim.

VIII. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Neni 34

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

34.1 Çmimorja është përcaktuar në bazë të Shtojcës 1 a të Udhëzimit Administrativ MSH 04/2007 mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Lloji i Shërbimit	
1	Egzaminimi mjekësor i mjekut të përgjithshëm në QKMF, QMF ose në AMF, pa analiza laboratorike dhe pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1 €
2	Egzaminimi specialistik në QKMF, QMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2 €
3	Egzaminimi specialistik në QKMF, QMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes	5 €
4	Egzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6 €
5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.3 €
6	Ultrazëri standard	2 €
7	Radiografia	2 €
8	EKG	0.5 €
9	Analizat laboratorike-hemogrami dhe urina	1 €
10	Analizat laboratorike (komplet)	3 €
11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve	1 €
12	Audiograma	1 €
13	Shpërlarja e veshit	1 €
14	Dhënja e injeksionit intramuskulor në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1 €
15	Dhënja e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1 €
16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3 €
17	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1 €
18	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	18 €
19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18 €
20	Dhënja e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumentit tjetër në baz të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5 €

21 Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj. (për një orë)

25 €

22. Lartësia e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave në pronësi të komunës të cilat kanë karakter social përcaktohet sipas Ligji nr. 03/1-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, neni 9 Përcaktimi i qirasë;

22.1 Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës:

$$Qjm = Vb \times 0.04$$

ku:

12 Qjm - Qiraja jo profitabile mujore

22.2. Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit.

22.3. Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.

22.4. Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër përqind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër përqind (4%) e vlerës së banesës në treg.

22.5. Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 të nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 të nenit 19 të këtij ligji vlera e qirasë e shprehur me Euro/m², përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal.

Neni 35

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësor

35.1 Çmimorja është përcaktuar në bazë të Shtojcës 2 a të Udhëzimit Administrativ MSH 04/2007 mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Lloji i Shërbimit	1 €
1	Vizita e parë stomatologjike	1.5 €
2	RTG i dhëmbit	4 €
3	Mbështetje e përhershme me amalgam	5 €
4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5 €
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo me kompozitë)	6 €
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo me kompozitë)	6 €
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6 €
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6 €
9	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6 €
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6 €
11	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	1 €
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjes	1 €
13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1 €
14	Vulosja e fisurave	

15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1 €
16	Mënjanimi i depozitimeve të (forta heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	3 €
17	Kieretazha e xhepave paradonta (një dhëmb)	1 €
18	Nxjerrja e dhëmbit	1.5 €
19	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.5 €
20	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1 €
21	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.5 €

Neni 36

Çmimorja për certifikatat shëndetësore

36.1. Çmimorja është përcaktuar në bazë të Shtojcës 1a të Udhëzimit Administrativ MSH 04/2013
Certifikatat shëndetësore.

Nr.	Lloji i Certifikatës	Çmimi
1	Certifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim	10 €
	1. Certifikata shëndetësore për regjistrim në çerdhe ose kopsht fëmijësh;	
	2. Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla fillore, të mesme, të larta, fakultete, dhe nivele tjera të shkollimit;	
	Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla të veçanta të të gjitha niveleve dhe shkolla tjera për profesione të veçanta	
2	Certifikata shëndetësore për punësim	15 €
	1. Certifikata shëndetësore për punësim	
	2. Certifikata shëndetësore për punësim në vende me kushte të veçanta pune	50 €
	3. Certifikata shëndetësore për punë profesionale në lëmin e komunikacionit.	50 €
3	Certifikata shëndetësore për paisje me patentë shoferi	20 €
	1. Certifikata shëndetësore për paisje me patentë shoferi për kategoritë A1, A, B1, B, BE, M, L dhe T	
	2. Certifikata shëndetësore për paisje me patentë shoferi për kategoritë C1, C, D1, D, CIE, CE, DIE, dhe DE	50 €
4	Certifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të përgjithme dhe të veçanta	50 €
5	Certifikata shëndetësore për përcaktimin e zotësisë së veprimit	50 €
6	Certifikata shëndetësore për përcaktimin e shkallës së lëndimeve trupore dhe/ose psikike	
7	në sportin amator	10 €

	Certifikata / libreza shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të sportistëve	Libreza shëndetësore për sportistë profesional	20 €
8	Certifikata shëndetësore për aftësinë psiko-fizike të bashkëshortëve për adopotim të fëmijës		50 €
9	Certifikata shëndetësore për aftësinë shëndetësore fizike dhe psikike për paisje me leje për armë		50 €
10	Certifikata e vdekjes, në rastet kur ka nevojë për autopsy anatomo-patologjike		50 €
11	Libreza Sanitare		15 €

32.2. Lirohen nga pagesa për nxjerrjen e Certifikatave pika 1, 1.1, 1.2 .1.3 dhe pika 7 numer 7.1 në sektorin publik, sipas Ligjit për shëndetësi. Përfshihen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj.

Neni 37

Tarifat dhe ngarkesat e ndryshme

37.1.	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës	0 €
37.2.	Vërtetim për pranimin e shtetësisë së Kosovës	0 €
37.3.	Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari	0 €
33.4.	Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale	0 €
37.5.	Vërtetim për bashkimin familjar	0 €
37.6.	Vërtetim për mbajtje të armës	0 €
37.7.	Çdo vërtetim tjetër	0 €
37.8.	Kerkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	0 €

IX. DREJTORIA E ARSIMIT

Neni 38

Mësimi për të rritur (niveli i mesëm)

38.1.	Regjistrimi i vitit	100 €
38.2.	Lënda e praktikës profesionale	50 €
38.3.	Provimi diferencial	10 €
38.4.	Provimet përfundimtare të klasës (vlerësimi i brendshëm dhe lëshimi i certifikatës)	30 €
38.5.	Diploma e përfundimit të shkollimit	20 €
38.6.	Lënda me shkrim dhe me gojë	10 €

Neni 39

Riprovimet e mësimi për të rritur pas kalimit të afatit ligjor të provimeve

	15 €
39.1. Lënda e praktikës profesionale	10 €
39.2. Lënda me shkrim dhe me gojë	8 €
39.3. Lënda me gojë	

Neni 40

